



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

BASHKIA SHKODËR  
DREJTORIA E MJEDISIT DHE ENERGJISË SË RINOVUESHME



24778  
Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Shkodër, më 23. 10. 2024

Lënda: Dërgohet projekt- vendim dhe relacion

**KËSHILLIT BASHKIAK, SHKODËR**

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur ju dërgojmë për kompetencë shqyrtimi projekt-vendimin dhe relacionin:

**“PER MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË MBROJTJES SE  
BIODIVERSITETIT”**

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt,





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E MJEDISIT DHE ENERGJISË SË RINOVUESHME

Nr. \_\_\_\_\_ prot

Datë \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_.2024

RELACION

PER

**“ MIRATIMIN E PLANIT LOKAL TË MBROJTJES SË BIODIVERSITETIT ”**

Drejtar : Këshillit Bashkiak Shkodër

Të nderuar këshilltarë,

Po paraqes para Jush Planin Lokal te Mbrotjtjes se Biodiveritetit te Bashkise Shkodër.

Ky plan është një dokument strategjik për ruajtjen e shumëlojshmërisë se gjallesave dhe ekosistemeve që ndodhen në territorin e Bashkisë Shkodër. Ky plan vjen në funksion të Strategjisë Kombëtare të Mbrotjtjes se Biodiversitetit, në përbushje të politikave kombëtare të Mbrotjtjes se biodiversitetit si edhe në zbatim të strategjisë se Planit të Përgjithshëm Vendor për ruajtjen e mjedisit në territorin e Bashkisë Shkodër. Ky plan ka si qëllim rregullimin e përdorimit të qëndrueshëm të biodiversitetit nëpërmjet integrimit të elementeve kryesore të biodiversitetit në strategjitet, planet, programet dhe vendimmarrjet e të gjitha niveleve.

Plani vjen i rishikuar pas një periudhe 7 vjeçare të zbatimit të tij. Gjate kësaj periudhe kemi situata apo të dhëna të reja ne raport me biodiversitetin e zonës dhe aktivitetet apo projektet e ndërmarra në territorin e bashkisë Shkodër dhe jo vetëm. Plani synon të paraqesë një panoramë të re të gjendjes aktuale të biodiversitetit dhe të marre parasysh angazhimet e duhura për të mbrojtur biodiversitetin e zonës.

Plani vjen edhe si një përbushje e detyrimit ligjor që bashkia Shkodër, si pushtet vendor ka në ruajtjen e biodiversitetit të përcaktuar në nenin 27 pika 6 të Ligjit nr 139/2015 “ Per vetqeverisjen vendore” i ndryshuar si edhe ligjet sektoriale si ligjin nr.9587, datë 20.7.2006 “Për mbrotjtjen e biodiversitetit”, të ndryshuar., Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrotjtjen e mjedisit” i ndryshuar, etj

Ky plan ka si qëllim rregullimin e përdorimit të qëndrueshëm të biodiversitetit nëpërmjet integrimit të elementeve kryesore të biodiversitetit në strategjitet, planet, programet dhe vendimmarrjet e të gjitha niveleve.

Qëllimet kryesore të Planit Lokal të Veprimit për Biodiversitetin për Bashkinë e Shkodër janë renditur si me poshtë:

1. Përcaktimi, vlerësimi i gjendjes së natyrës në hapësirën administrative të bashkisë Shkodër.
2. Vlerësimi i problemeve dhe rreziqeve që i kanosen pasurive natyrore dhe larmisë biologjike në veçanti si dhe vlerësimi i cilësisë së jetës në përgjithësi;
3. Përcaktimi i strategjive specifike dhe aktivitetave për uljen e rreziqeve nga ata më serioze në dëmtimin e vlerave të biodiversitetit;
4. Përmirësimin e situatës së përgjithshme ekologjike në Bashkinë e Shkodër e cila ndikon drejtperdrejt në permisresimin e situatës në Rajonin e Shkodrës në përgjithësi, nëpërmjet përcaktimit të masave konkrete, strategjive mjedisore më efikase;
5. Rritjen e vetëdijes dhe përgjegjësisë qytetare për ruajtjen e vlerave të biodiversitetit, të rritjes së përkrahjes së komunitetit për aksione dhe investime ekologjike;
6. Rritjen e cilësisë së vetëqeverisjes lokale dhe përfshirjes së shoqërisë civile, për qeverisjen me programe miqësore me mjedisin si dhe zbatimin e tyre, promovimin e vlerave të biodiversitetit, tërheqjen e donatorëve për financimin e projekteve etj.

Ky plan hartohet në nivel lokal nga Bashkia Shkodër. Zbatimi i këtij plani është konceptuar që të mbështetet në metodën gjithëpërfshirëse ku çdo individ i komunitetit të ketë të drejtën e dhënies së kontributit të tij në këtë proces.

Biodiversiteti, si tërësi e llojeve dhe ekosistemeve tokësore e ujore në territorin e Bashkisë të Shkodrës, shfaq ndryshime midis zonave dhe habitateve. Në përgjithësi, e gjithë zona e administrative e Bashkisë Shkodër është e pasur në burime natyrore dhe diversitet të pasur të florës, faunës e habitateve. Kjo është evidente veçanërisht në zonat e mbrojtura *Liqeni Shkodrës*, *Parku kombëtar "Alpet e Shqipërisë"*, *Peizazhi i mbrojtur Bunë-Velipojë*, apo *parku kombëtar "Lugina e Shalës"* të cilat kanë biodiversitetin më të pasur brenda territorit të Bashkisë. Llojet, gjenet, dhe ekosistemet janë prodhim i një evolucioni mbi tre miliard vjeçar, ndaj prishja e balancave mund të jetë me pasoja të rënda për gjithë ekosistemin dhe vetë njeriun.

Territori i Bashkisë Shkodër është i mbuluar gjithandej me zona me biodiversitet të larte. Kjo dëshmohet mjaft mire edhe me sipërsaqet e zonave të mbrojtura, të cilat zënë rreth 50 % të sipërsaqes se Bashkisë Shkodër si dhe numri i konsiderueshëm i monumenteve natyrore, krahasuar edhe me bashkitë e tjera të qarkut Shkodër.

Bashkia Shkodër në strategjinë e saj në mbrojtje të mjedisit nxit nëpërmjet politikave, planeve, projekteve përmirësimin e infrastrukturës urbane, përdorimin e teknologjive miqësore me mjedisin, zhvillimin e ekonomisë së gjelbër në të gjithë sektorët e saj.

Zhvillimi i qëndrueshëm dhe shume funksional të burimeve pyjore dhe kullosore që sigurojnë shtimin e sipërsaqeve pyjore rrisin prodhimitarinë dhe aftësinë ripërtëritëse të pyjeve, parandalojnë degradimin e mëtejshëm te tokës, mbrojnë biodiversitetin e sigurojnë potencial maksimal për te përbushur funksionet ekologjike, ekonomike dhe sociale në nivel lokal, kombëtar dhe global pa cenuar ekosisteme të tjera.

Kujdes i veçantë do të tregohet edhe për zonat e mbrojtura natyrore si **Parku i Alpeve**, Liqeni i Shkodrës, Lumi Buna (**Park Kombëtar** sipas PPK), Lumi Buna- Velipoja (Peizazh i Mbrotur), si zona të cilat mbarin numrin më të madh të llojeve me rëndësi të veçanta biologjike.

Planifikimi i mire i nderhyrjeve në biodiveristetin urban edhe ne hapësirat e vogla të gjelbra mund të sigurojnë shërbime me ndikim të madh në ekosistem. Hapësirat e gjelbëruara sigurojnë benefite edhe për banorët e zonave urbane. Këto benefite ofrojnë rekreacion për qytetarët, eksperiencë me natyrën, ndikim pozitiv në mirëqenien mendore, hapësirë të shëndetshme për aktivitet fizik, rritje të cilësisë së mjedisit urban, ulje të temperaturave gjatë stinës së ngrohtë dhe ruajtje të nxehtësisë gjatë stinës së ftohtë, hijezim, dhe rritje të vlerës së pronës. Bashkia Shkodër ka potencial të lartë llojesh bimore të cilat spikatin për vlerat e tyre të larta, të tilla si bimët relikte që rriten në mënyrë natyrale në lulishtet e qytetit dhe oborret e shtëpive shkodrane, të trashëguara ndër vite brez pas brezi.

Plani identifikon edhe faktoret degradues apo kercenues te habitateve apo humbjes se biodiversitetit. Kështu janë identifikuar , fragmentimi i ekosistemeve ujore , humbje e habitateve të shkaktuara nga përmbytjet , zhdukja e foreës dhe faunës për shkak të përdorimit të mekanizmave joligjore , eutrofikimi i ujave të Ligenit apo edhe erozioni i tokes.

Thelbin e biodiversitetit e përbëjnë llojet. habitatet dhe ekosistemet. ndaj dhe mbrojtja e tyre duhet të favorizojë llojet më të kërcënua si dhe ato me rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare. Në këtë këndvështrim, rëndësi të veçantë në menaxhimin e një zone me vlera natyrore është menaxhimi i zgjuar i biodiversitetit.

Plani jep përsitimet që arrihen nga një shfrytëzim të qëndrueshëm i biodiversitetit sic janë: Përdorimii Pyjeve. bimët mjeksore apo prodhimeve pyjore. turizmi , ekoturizmi apo agroturizmi ku : mjafton të zhvillojmë një agroturizëm që është në harmoni me burimet autentike , historinë. traditën, kuzhinën dhe mbi të gjitha një biodiversitet pa ndërrhydrjen e njeriut , kështu shtrohet rruga për një zhvillim të qëndrueshën në harmoni me resurset tona.

Plani jep edhe disa nga praktikat që mund të aplikohen në mbështetje të agroturizmit dhe ekoturizmit.

Plani parashikon objektivat strategjikë , si edhe ato specifikë afatshkurtër .afatmesëm dhe afatgjatë.

Plani parashikon edhe Matricën e Zgjidhjeve të propozuara.

Plani parashikon një shtrirje kohore 6 vjeçare për implementimin objektivave të tij. por qasja e tij ofron mundësinë e përdorimit të tij edhe pas këtij afati. Plani parashikon edhe Matricën e Zgjidhjeve të propozuara

Ky plan vjen edhe si një përbushje e detyrimit ligjor që Bashkia Shkodër, si pushtet vendor ka në ruajtjen e biodiversitetit të përcaktuar në neni 16 te ligjit nr.9587, datë 20.7.2006 "Për

mbrojtjen e biodiversitetit". I ndryshuar , VKM nr 31 datë 20.01.2016 " Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike për mbrojtjen e biodiversitetit".


Mbështetur nenin 27 pika 5 e ligjit nr. 139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar , neni 54 pika k ; në nenin 16 te ligjit nr.9587. datë 20.7.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit". i ndryshuar , VKM nr 31 datë 20.01.2016 " Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike për mbrojtjen e biodiversitetit

Kërkjmë

"Miratimin e Planit Vendor të Biodiversitetit "sipas materialit bashkëlidhur.

Duke ju falenderuar, ju flojmë në miratimin e projekt vendimit.

*Fidel Shllaku*  
*Asistent*





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR

Nr. \_\_\_\_ Prot

Shkodër, më \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_.2024

**PROJEKT-VENDIM**  
**NR. \_\_\_\_\_, DATË \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_.2024**

**PER**

**“ MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË MBROJTJES SË BIODIVERSITETIT”**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_.2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur nenin 27 pika 6. nenin 54 shkronja k të ligjit nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; nenin 16 të ligjit nr.9587 dt 20.07.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit” të ndryshuar, ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” të ndryshuar, VKM nr.31 dt 20.01.2016 “ Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike për mbrojtjen e biodiversitetit” dhe sipas relacionit të Drejtorisë së Mjedisit dhe Energjisë së Rinovueshme nr \_\_\_\_ prot. datë \_\_\_\_\_

**VENDOSI**

1. Të miratojë “ Planin vendor të mbrojtjes së biodiversitetit” sipas materialit bashkëlidhur
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Shkodër.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.



Z.v. Kryetar

Enioli Dylvi

Drejtoria e Mjedisit dhe Energjisë së Rinovueshme

Hilda Shillaku

Drejtoria e Pergjithshme Juridike, Burimeve Njerezore dhe Sherbimeve Mbeshtetese

Denis Dashoff

Drejtoria Juridike

S. Leggjo